REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
DZ/Nr. Prot. 2-180/3154
Nr. i fax.
Data 07/05/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

**Kuvendi i Komunës**
**Nr. 002/28**
**Datë: 30.04.2026**

Bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr.03/L-40, neni 12, paragrafi 12.2, Statutitt ë Komunës së Junikut (të dates 29.09.2010), neni 21, paragrafi 21.1 pika j), Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.04.2026, mori këtë:

# VENDIM

**për fillimin e hartimit të (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale**

I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt) Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale / në tekstin e mëtejmë (projekt) Rregullorja/.

II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt) Rregulloreje, sipas këtij vendimi është krijimi i bazës ligjore për fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2027.

III. Bartëse e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi është Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut.

IV. Bartësja e hartimit të (projekt) Rregullores është e obliguar që (projekt) Rregulloren ta hartoj në afat prej 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

V. Autorizohet Kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi ta emëroj grupin punues për hartimin e (projekt) Rregullores nga pika I e këtij Vendimi.

VI. (projekt) Rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik. Paraqitja e (projekt) Rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.

VII. Pas hartimit (projekt) Rregullorja i procedohet kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim.

VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt) Rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.

**IX.** Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anë të të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

**X.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, respektivisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**XI.** Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministries përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës;
3. Ministria e Financave,
4. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
5. Shërbimi i Kuvendit dhe
6. Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Lolluni

